




**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova / Republic of Kosovo**  
**Këshilli Prokurorial i Kosovës/ Tužilaški Savet Kosova/ Kosovo Prosecutorial Council**

Këshilli Prokurorial i Kosovës, në bazë të nenit 4 paragrafi 1.27 të Ligjit nr. 03/L-224 për Këshillin Prokurorial të Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" nr. 83 publikuar me dt. 29 tetor 2010), në takimin e mbajtur me datë 29 maj 2017, miraton:

**RREGULLORE NR.04/2017**

**PËR KLASIFIKIMIN E INFORMACIONEVE TË SISTEMIT PROKURORIAL  
TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

**Neni 1**  
**Qëllimi**

Kjo rregullore ka për qëllim klasifikimin e informacioneve të sistemit prokurorial të Republikës së Kosovës.

**Neni 2**  
**Fushëveprimi**

Kjo rregullore zbatohet në tërë Sistemin Prokurorial.

**Neni 3**  
**Përkufizimet**

1. Shprehjet e përdorura në këtë Rregullore kanë këto kuptime:
  - 1.1 Sistemi prokurorial – Këshilli Prokurorial i Kosovës dhe Prokurori i Shtetit.
  - 1.2 Qasje – aftësia apo mundësia për të marr njohuri rreth informacioneve të klasifikuara.
  - 1.3 Klasifikim – nënkupton aktin apo procesin e klasifikimit të informacionit.

- 1.4 Autoriteti i Klasifikimit - nënkupton çdo person brenda Sistemit Prokurorial që ka kompetence origjinale apo të deleguar për klasifikimin e informacioneve.
- 1.5 Informacioni i Klasifikuar - nënkupton çdo informacion ose material që kërkon nivel mbrojtje të veçantë.
- 1.6 Deklasifikim - nënkupton çdo ndryshim të autorizuar të statusit nga niveli i informacionit të klasifikuar në informacion të paklasifikuar.
- 1.7 Degradim - ndryshimi i statusit të informacionit nga një nivel i përcaktuar në nivel më të ultë të klasifikimit të informacionit.
- 1.8 Dokumentet - nënkupton çdo mjet fizik apo elektronik kur regjistrohet informacioni.
- 1.9 Informacion - njohuri që mund të komunikohet në çfarëdo forme.
- 1.10 Informacioni nga Autoritetet e Jashtme të Klasifikimit - nënkupton informacione e dhënë sistemit prokurorial të Republikës së Kosovës nga një prokurori i huaj apo organizate qeveritare ndërkombëtare.
- 1.11 Bartësit e autorizuar të informacioneve të klasifikuara - nënkupton personin e autorizuar në kuadër të Sistemit Prokurorial i cili ka në posedim informacionin e klasifikuar.

#### **Neni 4**

##### **Nivelet e Klasifikimit**

- 1. Informacioni mund të klasifikohet në nivelet si në vijim:
  - 1.1 SEKRET - zbatohet për informacionet, hapja e paautorizuar e të cilave do t'i shkaktonte dëm serioz Sistemit Prokurorial;
  - 1.2 Konfidencial - zbatohet për informacionet, hapja e paautorizuar e të cilave do t'i shkaktonte dëm Sistemit Prokurorial;
  - 1.3 E kufizuar - zbatohet për informacionet, hapja e paautorizuar e të cilave do të ishte e pafavorshme për Sistemin Prokurorial.

## Neni 5 Autoriteti i Klasifikimit

1. Kompetencën origjinale për klasifikim në nivelin "SEKRET" kanë:
  - 1.1 Kryeprokurori i Shtetit;
  - 1.2 Kryeprokurori i Prokurorisë së Apelit;
  - 1.3 Kryeprokurori i Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, dhe
  - 1.4 Kryeprokurorët e Prokurorive Themelore.
2. Kompetencën origjinale për klasifikim në nivelet "KONFIDENCIALE" dhe "E KUFIZUAR" kanë:
  - 2.1 Personat e përmendura në paragrafin 1 të këtij neni;
  - 2.2 Kryesuesi i Këshillit Prokurorial të Kosovës;
  - 2.3 Prokurorët e prokurorive të Kosovës;
  - 2.4 Drejtori i Sekretariatit të KPK-së, dhe
  - 2.5 Drejtori i Njësitit për Shqyrtimin e Performancës së Prokurorisë.
3. Autoritetet e klasifikimit të përcaktuar në paragrafin 1 mund të delegojnë këtë kompetencë për klasifikim në kuadër të fushëveprimit të tyre te prokurorët.
4. Autoritet e klasifikimit të përcaktuar në paragrafin 2 të këtij neni mund të delegojnë këtë kompetencë për klasifikim në kuadër të fushëveprimit të tyre te zyrtarëve drejtues.
5. Zyrtarët e autorizuar për klasifikimin e informacioneve në një nivel të përcaktuar kanë të drejtë t'i klasifikojnë informacionet edhe në nivel më të ulët.
6. Delegimi i kompetencës për klasifikim kufizohet në minimumin e kërkuar për ta zbatuar këtë ligj. Autoriteti i Klasifikimit i përcaktuar në paragrafët 2 dhe 5 të këtij neni janë përgjegjës që të sigurojnë se çdo delegim i kompetencës për klasifikim tek prokurorët dhe zyrtarët drejtues revokohet nëse nuk ka nevojë të qartë dhe të vazhdueshme që zyrtarët të ushtrojnë kompetencë të tillë klasifikimi.
7. Çdo delegim i kompetencës për klasifikim bëhet me shkrim dhe e identifikon qartë zyrtarin me emër dhe titull të pozitës si dhe autoritetin e klasifikimit.

8. Kur një zyrtar, punonjës apo kontraktues, që nuk ka kompetencë origjinale apo të deleguar për klasifikim, prodhon një informacion, e cila sipas mendimit të atij personi kërkon klasifikim, ai/ajo e mbron atë informacion dhe menjëherë ia transmeton informacionin autoritetit të klasifikimit. Autoriteti i Klasifikimit vendos brenda tetë (8) ditësh nëse ky informacion duhet klasifikuar.
9. Autoritetet e klasifikimit janë përgjegjëse të sigurojnë masa të përshtatshme të sigurisë për informacionet e klasifikuara në pajtim me legjislacionin e aplikueshëm.

## **Neni 6**

### **Kriteret e Klasifikimit**

1. Autoriteti i Klasifikimit vendosë nëse informacioni duhet klasifikuar dhe përcakton nivelin e klasifikimit të informacionit që në momentin kur prodhohet informacioni.
2. Vendimi nëse duhet klasifikuar informacioni dhe përcaktimi i nivelit të klasifikimit do të jetë në pajtim me legjislacionin në fuqi dhe bazohet në një vlerësim të rendit publik dhe pasojave të dëmshme që mund të rezultojnë për interesat e sigurisë së Sistemit Prokurorial nga hapja e paautorizuar e informacionit të tillë. Vlerësimi bëhet me shkrim dhe i bashkëngjitet si shtojcë informacionit.
3. Autoriteti i Klasifikimit mund të vendos lidhur me kategoritë/llojet e klasifikimit të informacionit dhe kohëzgjatjen e këtij klasifikimi. Lista e klasifikimit të kategorive të informacionit do të jetë pjesë e kësaj Rregulloreje.
4. Autoriteti i Klasifikimit i shmanget klasifikimit të tepërt të informacioneve dhe atyre u cakton vetëm nivel të tillë të klasifikimit që është i nevojshëm për ta ruajtur interesat e Sistemit Prokurorial.

## **Neni 7**

### **Kohëzgjatja e klasifikimit**

1. Informacioni qëndron i klasifikuar vetëm gjersa kërkon mbrojtje apo nëse parashihet ndryshe me legjislacionin në fuqi. Përveç nëse legjislacioni në fuqi ose Autoriteti i Klasifikimit e ka caktuar një datë ose ngjarje të veçantë për deklasifikim afatet në vijim vlejnë për deklasifikim automatik dhe atë:

- 1.1 Informacionet e klasifikuara në nivelin **SEKRET** qëndrojnë të klasifikuara (15) vite.
  - 1.2 Informacionet e klasifikuara në nivelin **KONFIDENCIAL** qëndrojnë të klasifikuara (5) vite.
  - 1.3 Informacionet e klasifikuara në nivelin **E KUFIZUAR** qëndrojnë të klasifikuara (1) vit.
- 2 Përjashtimisht nga nen-paragrafët 1.2 dhe 1.3 mund të zgjatet afati i klasifikimit të informacionit të klasifikuar nëse vlerësohet se informacioni i klasifikuar apo kategoritë/llojet e informacioneve të klasifikuara kanë nevojë ende për mbrojtje.

#### **Neni 8**

##### **Procedura e Deklasifikimit Degradimit dhe Ngritjes së Nivelit**

1. Autoriteti i Klasifikimit sipas nevojës rishikon informacionin e klasifikuar brenda fushëveprimit organizativ të tij/saj dhe rivlerëson nëse informacioni i klasifikuar duhet të deklasifikohet, degradohet apo t'i ngritet niveli i klasifikimit.
2. Pas marrjes së vendimit për deklasifikim, degradim dhe ngritje të nivelit të klasifikimit të informacioneve, Autoriteti i Klasifikimit informon institucionet përkatëse dhe të adresuarit tjerë të cilëve ju është dërguar dokumenti apo një kopje e tij.
3. Kur një informatë e klasifikuar është dhënë nga Autoriteti i Jashtëm i Klasifikimit, ajo nuk duhet të degradohet apo të deklasifikohet, pa njoftim paraprak të origjinerit.

#### **Neni 9**

##### **Kriteret për deklasifikim, degradim apo ngritje të nivelit**

1. Autoriteti i Klasifikimit deklasifikon apo degradon një informacion të klasifikuar nëse:
  - 1.1 informacioni i klasifikuar nuk kërkon mbrojtje i cili akordohet me nivelin ekzistues të klasifikimit;
  - 1.2 informacioni nuk dëmton rendin publik e as nuk paraqet rrezik të papranueshëm për sigurinë e Sistemit Prokurorial, dhe

- 1.3 autoriteti i jashtëm i klasifikimit ka degraduar apo deklasifikuar informacionin e klasifikuar dhe një deklasifikim apo degradim nuk është në kundërshtim me legjislacionin në fuqi në Republikën e Kosovës.
2. Autoriteti i Klasifikimit ngritë nivelin e klasifikimit nëse informacioni kërkon mbrojtje i cili akordohet me nivelin më të lartë të klasifikimit.

## **Neni 10**

### **Shënjimi i informacioneve të klasifikuara**

1. Të gjitha dokumentet që përmbajnë informacione të klasifikuara në ballinë duhet të mbajnë këtë shenjim:
- 1.1 nivelin e klasifikimit;
  - 1.2 datën dhe vendin e klasifikimit;
  - 1.3 emrin dhe titullin e pozitës së autoritetit klasifikues;
  - 1.4 institucionin publik të prejardhjes;
  - 1.5 Numrin e regjistrimit, nëse "KONFIDENCIAL" apo "SEKRET";
  - 1.6 listën e shpërndarjes nëse ka, si dhe numrin e kopjeve;
  - 1.7 afatin e klasifikimit, dhe
  - 1.8 informacionin mbi deklasifikimin, degradimin apo ngritjes së nivelit të klasifikimit të informacionit.
2. Shënjetimet aplikohen varësisht nga niveli i klasifikimit si:
- 2.1 mbi dokumentet "E KUFIZUAR" me mjete mekanike apo elektronike;
  - 2.2 mbi dokumentet "KONFIDENCIALE" me mjete mekanike dhe me dorë apo duke shtypur mbi letër të regjistruar të vulosur që përpara, dhe
  - 2.3 mbi dokumentet "SEKRET" me mjete mekanike dhe me dorë.
3. Dokumenti i një autoriteti të huaj që përmban informacion të klasifikuar mbanë shënjetimet origjinale të klasifikimit apo mund të klasifikohet sipas legjislacionit të Republikës së Kosovës që parasheh shkallën e mbrojtjes të paktën të barabartë me atë që kërkohet nga institucioni që ka sjell informacionin nëse paraprakisht nuk është paraparë ndryshe me traktat apo me ndonjë instrument tjetër ndërkombëtar të detyrueshme.

## **Neni 11**

### **Kontestimi i Klasifikimit**

1. Bartësit e autorizuar të informacioneve të klasifikuara të cilët besojnë se statusi i tyre i klasifikimit nuk është i duhur apo nuk është i justifikuar mund t'i propozojnë autoritetit të klasifikimit që të rishqyrtoje vendimin.
2. Autoriteti relevant i klasifikimit do të vendos brenda (8) ditësh nga pranimi i propozimit për rishqyrtim.
3. Brenda tre (3) dite nga pranimi i vendimit, kërkesa mund të parashtrohet tek Autoriteti i Klasifikimit për të rishqyrtuar statusin e dokumentit të klasifikuar. Autoriteti i Klasifikimit vendos brenda pesë (5) dite lidhur me kërkesë. Në këtë rast zbatohen dispozitat mbi rishikimin administrativ sipas Ligjit për Procedurën Administrative dhe nuk ka efekt pezullues.

## **Neni 12**

### **Qasja në Informatat e Klasifikuara**

1. Qasja në informatat e klasifikuara si "E KUFIZUAR" do të lejohet për të gjithë prokurorët dhe zyrtarët që:
  - 1.1 Kanë nevojë të dinë me qëllim të kryerjes së detyrave të tyre zyrtare, dhe
  - 1.2 Kanë nënshkruar deklaratën e konfidencialitetit.
2. Qasja në informatat e klasifikuara si "KONFIDENCIALE" apo "SEKRET" do të lejohet për prokurorin e çështjes dhe zyrtarët e lartë për të përmbushur detyrat ashtu siç është përmendur në paragrafin 1 dhe që kanë certifikatën relevante të vlefshme të sigurisë.
3. Qasja në informatat e klasifikuara si "TOP-SEKRET" nga autoritetet kompetente jashtë sistemit prokurorial, do t'i lejohet Kryeprokurorit të Shtetit dhe/ose personit/personave që ai i autorizon.

## **Neni 13**

### **Kërkesa për Qasje në informata të klasifikuara**

1. Kërkesat për qasje në informatat e klasifikuara mund të parashtrohen me shkrim tek autoriteti kompetent. Autoriteti kompetent apo i deleguari i tij/saj do të vendos brenda shtatë (7) dite duke lejuar apo refuzuar qasjen në informata të klasifikuara në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2. Personi të cilit i është mohuar qasja në informacione të klasifikuara mund të kërkoj rishikim. Në këtë rast zbatohen dispozitat mbi rishikimin administrativ sipas Ligjit për Procedurën Administrative dhe nuk ka efekt pezullues.

#### **Neni 14**

##### **Klasifikimi derivativ**

Bartësit e autorizuar të informacioneve të klasifikuara të cilët riprodhojnë, nxjerrin pjesë të shkëputura, përmbledhin, inkorporojnë, parafrazojnë, rishpallin apo krijojnë në formë të re informacioneve të klasifikuara, zbatojnë shënjimet e klasifikimit në përputhje me shënjimet e klasifikimit që zbatohen ndaj informacionit origjiner.

#### **Neni 15**

##### **Shpërndarja dhe ruajtja e Informacioneve të Klasifikuara**

1. Informacionet e klasifikuara u shpërndahen vetëm personave të autorizuar.
2. Standardet e sigurisë që duhen zbatuar me qëllim të ruajtjes dhe shpërndarjes së informacioneve të klasifikuara do të rregullohen ndarazi.

#### **Neni 16**

##### **Transferimi i Informatave të Klasifikuara**

1. Informacionet e Klasifikuara nuk largohen nga objektet zyrtare dhe në asnjë mënyrë tjetër nuk transferohen te institucionet tjera publike përveç nëse parashihet me legjislacionin relevant në fuqi. Institucioni publik që pranon informacione të klasifikuara nuk lejon hapjen e atyre informacioneve pa aprovimin e autoritetit që i ka krijuar ato.
2. Autoriteti kompetent brenda Sistemit Prokurorial që e transferon këtë informacion të klasifikuar e mban shënimin e tij.
3. Standardet e sigurisë që duhen zbatuar me qëllim të transferimit së informacioneve të klasifikuara do të rregullohen ndarazi.

#### **Neni 17**

##### **Trajnimet**

Me qëllim të zbatimit të kësaj rregullore do të organizohen trajnime për prokurorët dhe personelin administrativ në sistemin prokurorial.

**Neni 18**  
**Hyrja në fuqi**

Kjo rregullore hyn në fuqi ditën e miratimit nga Këshilli Prokurorial i Kosovës.

Prishtinë, më 29 maj 2017



Blerim Isufaj

Kryesues

Këshilli Prokurorial i Kosovës